



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kultururu, Omladinu i Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1397 Më 26.04.2019
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT I PUNËS

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

JANAR-MARS 2019



Tabela e përmbatjes

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:.....	2
Arritjet ?.....	3
AKTIVITETE.....	4
TAKIME / VIZITAT.....	5
Ditët/Akademi Përkujtimore	6
Biblioteka “Sulejman Krasniqi”	7
Palestra e Sportit “Mizahir Isma”	7

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

-Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjëse dhe ushtron aktivitete të planifikuara, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

- ✚ Ka për detyrë të planifikojë apo të propozojë paralogaritë buxhetore të Drejtorisë, në kuadrin e organizatës buxhetore, të administratës komunale
- ✚ Të organizojë dhe përkujdeset për shënimin e datave me rëndësi dhe vlerave, ditëve përkujtimore, ditëve botërore, kulturore, rinore e sportive.
- ✚ Të organizojë debate, tryeza me shoqërinë civile, OJQ rinore, klubet sportive, organet shtetërore dhe sportistë, artistë, me qëllim të avancimit, zhvillimit dhe promovimit të vlerave të ndryshme në komunën e Rahovecit.

- Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- ✚ Shtëpitë e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc
- ✚ Salla e Sportit në Rahovec, fushat sportive
- ✚ Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, me nëndegë në Krushë të Madhe dhe Hoqë të Madhe.

- Përveç buxhetit komunal, kemi bërë përpjekje për gjetjen e burimeve të tjera financiare, duke përfshirë edhe ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

- Bashkëpunimi me komunat tjera, OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm.



Arritjet ?

- Gjatë tre muajve të parë të vitit 2019 janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nga Komuna.
- ✚ Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së
- ✚ Formimi i Këshillit Organizues për nder të manifestimit perkujtimor dhe kulturor “Flaka e Janarit 2019”.
- ✚ Formimi i Komisionit për verifikimin e aplikimeve në konkursin letrar, pamor dhe film dokumentar.
- ✚ Formimi i Këshillit Organizues për nder të Ditës së Republikës së Kosovës, 17 shkurt.
- ✚ Shpallja e konkursit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 Shkurtit.
- ✚ Filloi zbatimi i projektit: Mësim rreth agronomisë përmes kursit të anglishtes.
- ✚ Tenderi “ Furnizim me libra”, është në proces edhe gjatë vitit 2019.
- ✚ Përgatitje rreth bazës ligjore për shpalljen e thirrjes për subvencionimin e OJV-ve.
- ✚ Shpallja e thirrjes për aplikim në sektorin e sportit.
- ✚ Më 13 shkurt, ka filluar realizimi i projektit mësimor për Agronomi dhe zhvillim të turizmit, kursi i anglishtes. Kursi mundësohet nga DKRS në bashkëpunim me Bibliotekën e Prizrenit, ndërsa financohet nga Ambasada Amerikane.
- ✚ Mbështetje në projektin e fituar të Shoqatës së Gruas “Hareja”. Projekti: Radio-Taxi për gra të komunës së Rahovecit.
- ✚ Pagesa për kompaninë furnizuese me libra “Vlora, me vlerë prej 4.997 €. Nga 2018.
- ✚ Prezantimi i rregullores së palestrës “Mizahir Isma”, në KPF.
- ✚ Vazhdon projekti “Riparimi I Monumenteve Kulturore Historike” edhe gjatë vitit 2019.
- ✚ Përgatitja e tenderit (kontrata kornizë) për “Rekuizita për nevojat e komunës”.
- ✚ Aplikim në thirrjen e MKRS-së për botimin e veprave të atdhetarit Sulejman Krasniqini, si dhe për pasurimin e bibliotekave në komunën e Rahovecit.
- ✚ Përgatitja e tenderit (kontrata kornizë): “Pajisje me teknikë zërimi për Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj”-Rahovec.
- ✚ Është bërë përrurimi i sallës së edukatës fizike, në Shkollën e Mesme “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe. Projekt i DKRS-së. Financuar nga MKRS-së.
- ✚ Nënshkrimi i kontratave për subvencionim të klubeve dhe organizatave sportive të Komunës së Rahovecit.
- ✚ Përrurimi i Palestrës Sportive ‘Mizahir Isma’.
- ✚ Përkrahja ndaj klubeve sportive është rritur dukshëm përkundër viteve të kaluara në komunën e Rahovecit. 82.000 euro vetëm për vitin 2019.
- ✚ Formimi i Këshillit Organizues të edicionit të 18-të të festivalit Anadrinia Jehon 2019.
- ✚ Shfaqje teatrale në Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj”, në bashkëpunim me Bibliotekën e Prizrenit, me temë ‘Iku autobusi’.

- ✚ Përgatitje rreth bazës ligjore për shpalljen e thirrjes për subvencionimin e OJV-ve.
- ✚ Shpallja e thirrjes për aplikim në sektorin e kulturës dhe rinisë.



AKTIVITETE

- ✚ Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, Komuna e Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall konkurs për art letrar, pamor dhe film dokumentar me metrazh të shkurtër.
- ✚ Me rastin e manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, Komuna e Rahovecit ka organizuar aktivitete në nderim të dëshmorëve të rënë gjatë demonstratave për liri në Brestoc më 27 janar 1990.
- ✚ Po ashtu, është mbajtur edhe manifestimi qendror përkujtimor e kulturor “Flaka e Janarit” në Qendrën e Kulturore “Mensur Zyberaj” në Rahovec.
- ✚ Gjatë programit artistik, janë publikuar edhe fituesit e çmimeve letrare dhe të artit pamor.
- ✚ Homazhe në vendlëni të dëshmorëve më 17 shkurt.
- ✚ Koncert në bashkëpunim me Shkollën e Muzikës “Faik Sylka” më 17 shkurt.
- ✚ Gara në futboll të vogël (Fituesit kanë marrë shpërblime modeste).
- ✚ Është organizuar edhe tryezë mes historianëve të komunës së Rahovecit, konkretisht me Lidhjen e Historianëve “Ali Hadri” në Rahovec.
- ✚ Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, janë shënuar disa aktivitete nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën për barazi gjinore, Shoqatën e pavarur të gruas “Hareja” dhe SHL-Kosova.
- ✚ Në 20 vjetorin e Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në komunën e Rahovecit organizoi Orë Poetike me nxënës të shkollave dhe poetët rahovecas: Milazim Bajraj, Hazir Luta, Ymret Reshiti, Rabije Bytyqi, Ismajl Gashi dhe të tjerë.
- ✚ 22 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Ujit, është shënuar me aktivitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Është organizuar një vizitë në Radac me nxënësit e shkollave, të cilët ishin të shoqëruar nga mësueset e tyre dhe nga një mësues gjeografie. Ky aktivitet është organizuar si formë e ndërgjegjësimit të nxënësve për të shtuar kujdesin e tyre ndaj natyrës, planetit Tokë.
- ✚ Po vazhdojnë punimet, në kuadër të projektit “Riparimi i Monumenteve Kulturore Historike”. Punimet kanë vazhduar në disa kroje të qytetit.

- Në kuadër të kursit të anglishtes Agronomia dhe Zhvillimi i Turizmit, organizuam vizitë qendrës grumbulluese të frutave dhe perimeve Agro-Celina në Rahovec, ndërmarrjen Stone Castle dhe Shtëpinë e Verës e Rakisë, ku edhe u diskutua rreth turizmit dhe zhvillimit ekonomik të vendit.


TAKIME / VIZITAT

- Takim me zv.ministren Burbuqe Deva-Bakija, për t'u konsultuar rreth problemeve që hasim si komunë dhe mundësisë për të bashkëpunuar me institucione përkatëse.
- Vizitë në Bibliotekën e Prizrenit.
- Takim lidhur me projektin e Bankës Botërore "Përfshirja e të Rinjve në Zhvillimin Ekonomik Lokal", i financuar nga Fondi Japonez për Zhvillim Social. Takimi ka të bëjë me 15 % të shumës në lartësi të grantit përfitues të komunës të jetë e alokuar paraprakisht nga komuna me rastin e ndarjes së grantit.
- 22 shkurt- vizita e Ministrit të MKRS z. Kujtim Gashi në Palestrën e sportit.
- Vizitë punës së trajneres së Klubit Basketbollistik të Femrave, Arbnora Sokoli.
- Vizitë nga përfaqësuesit e Bibliotekës së Prizrenit, të cilët vijuan ecurinë e projektit, mësim rreth agronomisë dhe zhvillimit të turizmit, përmes kursit të anglishtes në komunën e Rahovecit.
- Takim me zyrën për barazi gjinore, pranë Administratës Komunale, SHPG "Hareja" dhe zyrtarë komunal. Diskutim rreth organizimeve për nder të Ditës së Gruas.
- Takim me stafin teknik të KF "Rahoveci". Përgatitjet për sezonin e ri të garave dhe gjendja aktuale në Klub, (bashkëpunimi).
- Bashkë me kryetarin vizituam Muzeun dhe Bibliotekën e Qytetit, për të parë gjendjen në të cilën janë objektet e vjetra dhe gjendja e librave në këtë bibliotekë.
- Takim me përfaqësues të Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike. Përgatitje rreth organizimit të aktiviteteve për nder të Ditëve Ndërkombëtare të Sportit.
- Mbledhje me Këshillin Organizues të Festivalit Folklorik Anadrinia Jehon 2019. Qëllim takimi, raportim nga anëtarët e këshillit, numrin e ftuar të ansambleve, diskutim rreth organizimit të Tryezës shkencore me temë "Roli dhe ndikimi i festivalit të folklorit "Anadrinia jehon" në ruajtjen dhe kultivimin e traditave kombëtare.
- Takim në Prishtinë me Këshillin Kombëtar dhe drejtorëve të drejtorive. Diskutim për Parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.
- Takim me drejtoreshën e DKRS-së, Saranda Hyseni. Takimi pati karakter të shkëmbimit të përvojave në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.
- Takime me Drejtorë të DKRS-së të komunave fqinje, diskutim për Javën e Bibliotekës.
- Vizitë nga përfaqësues të LMT, ushtar nga KFOR-i Austriak.
- Takim mes Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, Kryetarëve të Komunës së Rahovecit dhe Suharekës, Drejtorëve të Drejtorive të Sportit, Përfaqësues të klubeve të futbollit dhe basketbollit, dhe tifozët e ekipeve të futbollit dhe të basketbollit. Qëllimi i takimit, trajtimi i mosmarrëveshjeve në mes të tifozëve të futbollit dhe basketbollit të komunave të Suharekës dhe Rahovecit

Ditët/Akademi Përkujtimore

1.1 Shënimi i ditëve përkujtimore në komunën e Rahovecit.

Datë	Vendi	Aktiviteti
21 janar	Fortes-Sopniq	Homazhe
27 janar	Rahovec, Brestoc	“Flaka e Janarit”, homazhe
17 shkurt	Rahovec dhe fshatra	Shënimi i Ditës së Pavarsisë së Kosovës, aktivitete, homazhe
07 mars	Rahovec dhe fshatra	Epopeja e UCK-së, homazhe
25 mars	Fortes	tubim, homazhe
25 mars	Celinë	tubim, homazhe
25 mars	Brestoc	tubim, homazhe
26 mars	Krushë e Madhe	tubim, homazhe
30 mars	Opterush	tubim, homazhe
31 mars	Pastasel	tubim, homazhe



Biblioteka "Sulejman Krasniqi"

- ✚ Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- ✚ Klasifikimi dhe katalogimi i librit
- ✚ Regjistrimi i anëtarëve të rinj
- ✚ Përgatitja e raporteve mujore
- ✚ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, konkretisht Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, ndau 236 tituj librash të rinjë degës së Bibliotekës në Krushë të Madhe.
- ✚ Furnizimi i Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" me libra nga fondi i subvencionuar nga MKRS-së, donacion nga MKRS në vlerë prej 1500€.
- ✚ Librat kanë arritur ne bibliotekë, ku numërohen mbi 61 tituj, me afro 513 ekzemplarë të rinjë.
- ✚ Vizitat e organizuara të nxënësve të shkollave të komunës së Rahovecit.
- ✚ Autori Shefqet Dibrani i dhuroi Bibliotekës 34 ekz.libra.
- ✚ Autori Sabit Gashi i dhuroi bibliotekës tre ekz.libra.
- ✚ Autori Hysen Berisha i dhuroi Bibliotekës 2 ekz.libra.

Sektori i huazimit të librit:

- ✚ Janë regjistruar: 309 lexues, Sh.Fillore 258, Sh.Mesme 26, Student 8, Të tjerë 17.
- ✚ Shërbime: 2188, Meshkuj 938, Femra 1250.
- ✚ Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 154 përdorues.

1.1 Antaresimi në bibliotek për muajin Janar-Shkurt-Mars

Anëtar	Me pagesë	Gratis	Libra të lexuara	Meshkuj	Femra
309	303	6	2188	938	1250

1.2 Tabela e lexuesve për muajin Janar-Shkurt-Mars

Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
258	26	8	17	126	183	309

Palestra e sportit "Mizahir Isma"

- ✚ 27 shkurt, përrurimi i Sallës së Sportit "Mizahir Isma".
- ✚ 27 shkurt, ndeshja e pare zyrtare e KB Rahoveci në Palestrën Sportive.
- ✚ Më 11 mars, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka mbajtur aktivitet sportiv për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Aktiviteti është zhvilluar me qëllim të promovimit të sportit te vajzat e reja, në kuadër të projektit FIBA Europe Girls' Program. -250 VAJZA TË REJA kanë qenë pjesëmarrëse në kuadër të projektit "FIBA EUROPE GIRLS' PROGRAM" të organizuar në komunën e Rahovecit. Ndër to, kanë marrë pjesë 45 vajza nga komuna jonë, kryesisht të moshës 10-17 vjeç.



- ✚ Riaktivizimi i Klubit të Basketbollit të Femrave. 85 vajza të reja të interesuara për të marrë pjesë në Klubin e Basketbollit të Femrave në Rahovec/ mars.
- ✚ Më 28 mars është zhvilluar lojë nga KB Rahovevi-KB Ylli, në palestër.
- ✚ Është formuar Klubi i Futsallit “Rahoveci” nën udhëheqjen nga njerëz të kësaj fushe, Alfred Cena, Ahmet Bugari, Armin Tara, Jetmir Alirifa dhe disa të tjerë.
- ✚ Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe është luajtur finalja e garave shkollore në volejboll me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit.

